



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 358/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevc i anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Robertina Lekaj, duke vendosur përkitazi lidhur me ankesën e Fikrim Damka, nga Prizreni, kandidat për deputet nga radhët e subjektit politik KTDP, paraqitur kundër Agim Kume, Kryetar i Vendvotimit nr.2004a/07r, Komuna e Prizrenit, për shkak të parregullsive gjatë numërimit të votave, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare në seancën e panelit të mbajtur me 22.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e palejuar ankesa A.nr 358/2017 e datës 21.06.2017, e parashtruar Fikrim Damka, nga Prizreni, kandidat për deputet nga radhët e subjektit politik KTDP.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 21.06.2017, ka pranuar ankesën Anr. 358/2017, Fikrim Damka, nga Prizreni, kandidat për deputet nga radhët e subjektit politik KTDP, në të cilën pretendohet se në qendrën e votimit në shkollën “Motrat Qiriazi”, nr. 2004a/07r, në Prizren, nuk përputhen rezultatet nga ato që i ka shpallur KQZ-ja dhe të cilat ata i posedojnë. Sipas raportit të vëzhguesit numri i votave të kandidatit Fikrim Damka është 81 vota, ndërsa në formular janë regjistruar vetëm 5 vota. Parashtruesi i ankesës PZAP-it i ka kërkuar që të bëjë përmirësimin e këtij gabimi me numërimin e votave.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

Ankesa është e palejuar

PZAP-i, konstatoi se ankesa e parashtruar nga kandidati për deputet nga radhët e subjektit politik KDTP është e palejuar, për arsyes se rezultati preliminar ende nuk është shpallur nga KQZ-ja dhe se mund të ndryshoj në çdo moment, e po ashtu Qendra e Numërimit dhe Rezultateve QNR, ende është në fazën e procedimit të materialeve zgjedhore nga Qendrat e Votimit. Andaj, rezultati zgjedhor nuk ka marrë formën përfundimtare, dhe se në momentin e shpalljes së

rezultateve përfundimtare nga ana e KQZ-së, palët e pakënaqura në pajtim me nenin 105, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, mund të ushtroj ankesë në afatin prej 24 orëve.

Bazuar në arsyet e lartcekura dhe në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së i cili parasheh se “PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin standardet” dhe nenit 6.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, në të cilin përcaktohet se: “Ankesat të cilat janë të palejuar dhe të pasafatshme PZAP-i i hudhë poshtë me vendim”, lidhur me ankesën e lartë përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

A nr. 358/2017 më datën 22.06.2017



**Kryesuesi i Panelit
Hasan Shala**

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.